Përshkrimi: Pozicioni i investimeve ndërkombëtare paraqet bilancin e gjendjes së aseteve dhe detyrimeve financiare të një Kosovës me jorezidentë gjatë fund të një periudhe të caktuar. Grafiku paraqet raportin në mesë të aseteve (investimet e Kosovës jashtë vendit) dhe detyrimeve (investimeve të jorezidentëve në Kosovë) dhe si të tilla janë të dhëna kumulative. Deri në vitin 2011 të dhënat paraqiten në baza vjetore, ndërsa që nga viti 2012 në baza tremujore. Të dhënat janë paraqitur duke aplikuar parimin neto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 30.3

Grafiku 34. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare sipas sektorëve

Përshkrimi: Pozicioni i investimeve ndërkombëtare paraqet bilancin e gjendjes së aseteve dhe detyrimeve financiare të një Kosovës me jorezidentë gjatë fund të një periudhe të caktuar. Grafiku paraqet raportin në mesë të aseteve (investimet e Kosovës jashtë vendit) dhe detyrimeve (investimeve të jorezidentëve në Kosovë) sipas sektorëve siç janë: qeveria qendrore, banka qendrore, bankat komerciale, dhe sektorët tjerë (përfshirë sektorin privat). Klasifikimi i sektorëve është bazuar në standardet statistikore ndërkombëtare. Deri në vitin 2011 të dhënat paraqiten në baza vjetore, ndërsa që nga viti 2012 në baza tremujore. Të dhënat janë të paraqitura në sistemin kumulativ dhe duke aplikuar parimin neto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 31.2

Grafiku 35. Investimet direkte sipas shteteve kryesore investuese

Përshkrimi: Statistikat e investimeve të huaja direkte të paraqitura në këtë grafik paraqesin raportin në mes të investimeve të jorezidentëve në Kosovë ndaj investimeve të rezidentëve të Kosovës jashtë vendit. Grafiku paraqet shpërndarjen gjeografike të investimeve direkte në Kosovë dhe anasjelltas sipas shteteve kryesore investuese. Për më shumë, në grafik nuk janë paraqitur të gjitha shtetet që kanë investuar në Kosovë, por vetëm ato më të mëdha, për shkak të aspektit teknik të prezantimit. Të dhënat janë të paraqitura në sistemin kumulativ dhe duke aplikuar parimin neto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 31.1

Grafiku 36. Asetet Rezervë

Përshkrimi: Asetet rezervë përbëhen nga asetet e jashtme e klasifikuar konform statistikore ndërkombëtare. Të dhënat janë të paraqitura në sistemin kumulativ.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 30.4

Grafiku 37. Borxhi i jashtëm bruto

Përshkrimi: Borxhi i jashtëm i Kosovës paraqet detyrimet e rezidentëve të Kosovës ndaj jorezidentëve në një periudhë të caktuar kohore. Borxhi i jashtëm bruto ndahet në borxhin e jashtëm publik dhe privat. Në kuadër të borxhit privat përfshihet sektori privat që në rastin e Kosovës ka pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës. Deri në vitin 2011 të dhënat paraqiten në baza vjetore, ndërsa që nga viti 2012 në baza tremujore. Të dhënat janë të paraqitura në sistemin kumulativ dhe duke aplikuar parimin bruto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 32.1

Grafiku 38. Borxhi i jashtëm bruto sipas kreditorëve

Përshkrimi: Borxhi i jashtëm i Kosovës paraqet detyrimet e rezidentëve të Kosovës ndaj jorezidentëve në një periudhë të caktuar kohore. Borxhi i jashtëm i paraqitur në këtë grafik është klasifikuar sipas institucioneve ndaj të cilëve Kosova ka borxh. Të dhënat janë të paraqitura në sistemin kumulativ dhe duke aplikuar parimin bruto.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 32.2

PJESA II: TABELAT⁴

Tabela 1. Pasqyra e korporatave financiare

Përshkrimi: Korporatat financiare përbëjnë korporatat rezidente që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe mund të jenë korporata depozituese dhe korporata tjera financiare. Pasqyra e korporatave financiare paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave financiare në raport me sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real dhe llogaritet bazuar në pasqyrat e korporatave depozituese (BQK-së dhe bankave komerciale) dhe korporatave tjera financiare (kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare, dhe menaxherëve të aseteve). Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK, korporatat tjera depozituese, korporatat tjera financiare.

Tabela 2. Pasqyra e korporatave depozituese

Përshkrimi: Korporatat depozituese përbëhen nga banka qendrore dhe korporatat tjera depozituese (bankat komerciale). Pasqyra e korporatave depozituese paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave depozituese në raport me korporatat tjera financiare, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real dhe llogaritet bazuar në pasqyrën e BQK-së dhe të korporatave tjera depozituese. Tek korporatat depozituese konsolidimi bëhet në nivel të BQK-së dhe korporatave tjera depozituese. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Koncepti mbi parane e gjerë përfshin vetëm depozitat të cilët janë pjesë e parasë së gjerë dhe jo parane e gatshme. Këtu hyjnë depozitat e korporatave tjera financiare (kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, etj), depozitat e korporatave jofinanciare, ekonomive familjare, dhe OJSHEF-ve. Ky definimin është konsistent me definimin e Bankës Qendrore Evropiane.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK, korporatat tjera depozituese.

Tabela 3. Pasqyra e BQK-së

Përshkrimi: Pasqyra e BQK-së llogaritet bazuar në bilancin e gjendjes së BQK-së dhe përfshin pozicionin financiar të BQK-së në raport me korporatat tjera depozituese, korporatat tjera financiare, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real, dhe llogaritet bazuar në bilancin e gjendjes së BQK-së. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK.

⁴ Shënimet sqaruese i referohen grup-tabelave që për arsye të prezantimit në Buletinin Mujor Statistikor janë paraqitur të ndara (p.sh. Shënimet sqaruese do të paraqiten në nivel të Pasqyrës e korporatave financiare, që përfshinë tabelën 1.1. Asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme dhe tabelën 1.2. Obligimet).

Tabela 4. Pasqyra e korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Pasqyra e korporatave tjera depozituese paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave tjera depozituese në raport me BQK-në, korporatat tjera financiare, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Pasqyra e korporatave tjera depozituese përpilohet bazuar në bilancin e gjendjes së korporatave tjera depozituese. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Ekzistojnë disa ndryshime metodike në kuadër të obligimeve të korporatave tjera depozituese të cilat janë paraqitur në kuadër të shënimeve sqaruese të tabelës 12.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Bankat komerciale.

Tabela 5. Pasqyra e korporatave tjera financiare

Përshkrimi: Pasqyra e korporatave financiare përpilohet bazuar në bilancet e gjendjes të kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare, dhe menaxherët e aseteve. Pasqyra e korporatave tjera financiare paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave tjera financiare në raport me korporatat depozituese (bankën qendrore dhe bankat komerciale), sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Pasqyra e korporatave tjera financiare llogaritet bazuar në pasqyrën e pasqyrën e kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare dhe menaxherëve të aseteve. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Deri në fund të vitit 2011 të dhënat janë përpiluar dhe publikuar në bazë tremujore, ndërsa që nga janari 2012 në baza mujore (bëhet fjalë për statistikën mbi institucionet mikrofinanciare agjencitë për transferimin e parave). Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të projekteve statistikore Raporti Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare, Raportin mbi Normat e Kamatës së Institucioneve Mikrofinanciare si dhe Raporti Statistikor mbi Agjencitë për Transferimin e Parave.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Ndërmjetësit tjerë financiar, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, ndihmësit financiar.

Tabela 6. Pasqyra e ndërmjetësve tjerë financiar

Përshkrimi: Pasqyra e ndërmjetësve tjerë financiar përpilohet bazuar në bilancin e gjendjes të institucioneve mikrofinanciare. Pasqyra e ndërmjetësve tjerë financiar paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të ndërmjetësve tjerë financiar në raport me korporatat depozituese (bankën qendrore dhe bankat komerciale), kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, ndihmësit financiar, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Rrjedhimisht, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Deri në fund të vitit 2011 të dhënat janë përpiluar dhe publikuar në bazë tremujore, ndërsa që nga janari 2012 në baza mujore. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të projektit statistikor Raporti Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Institucionet mikrofinanciare.

Tabela 7. Pasqyra e kompanive të sigurimit

Përshkrimi: Pasqyra e kompanive të sigurimit përpilohet bazuar në bilancin e gjendjes së kompanive të sigurimit. Pasqyra e kompanive të sigurimit paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të kompanive të sigurimit në raport me korporatat depozituese (bankën qendrore dhe bankat komerciale), ndërmjetësit tjerë financiar, fondet pensionale, sektorin e jashtëm, ndihmësit financiar, sektorin fiskal dhe sektorin real. Rrjedhimisht, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Kompanitë e sigurimeve.

Tabela 8. Pasqyra e fondeve pensionale

Përshkrimi: Pasqyra e fondeve pensionale përpilohet bazuar në bilancin e gjendjes së fondeve pensionale. Pasqyra e fondeve pensionale paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të fondeve pensionale në raport me korporatat depozituese (bankën qendrore dhe bankat komerciale), ndërmjetësit tjerë financiar, kompanitë e sigurimeve, ndihmësit financiar, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Rrjedhimisht, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Fondet pensionale.

Tabela 9. Pasqyra e ndihmësve financiar

Përshkrimi: Pasqyra e ndihmësve financiar përpilohet bazuar në bilancin e gjendjes të agjencive për transferimin e parave. Pasqyra e ndihmësve financiar paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të ndihmësve financiar në raport me korporatat depozituese (bankën qendrore dhe bankat komerciale), kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Rrjedhimisht, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e

kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Deri në fund të vitit 2011 të dhënat janë përpiluar dhe publikuar në bazë tremujore, ndërsa që nga janari 2012 në baza mujore. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të projektit statistikor Raporti Statistikor mbi Agjencitë për Transferimin e Parave.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Agjencitë për transferimin e parave.

Tabela 11. Bilanci i gjendjes i BQK-së

Përshkrimi: Bilanci i gjendjes i BQK-së paraqet pozicionin financiar të BQK-së. Në kuadër të korporatave tjera financiare që janë paraqitur në anën e obligimeve të BQK-së përfshihen depozitat e kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale. Depozitat e qeverisë përfshijnë edhe depozitat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por që janë paraqitur si të ndara. Po ashtu, në kuadër të depozitave të qeverisë është përfshirë edhe pjesa e paguar e kuotës në FMN.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK.

Tabela 12. Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese paraqet gjendjen e agreguar të këtij nën sektori. Që nga qershori 2004 ekziston ndryshim metodik në sektorizimin e instrumenteve të caktuara në bilancin e gjendjes së korporatave të tjera depozituese. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të projekteve statistikore: Raporti Statistikor Bankar dhe Raporti mbi Normat e Kamatës. Për më shumë rreth projekteve statistikore në fjalë, shih vegëzat në vazhdim:

- Raporti Statistikor Bankar;
- Raporti mbi Normat e Kamatës.

Ndryshimet e detajuara metodike janë paraqitur në kuadër të Tabelës 12. Depozitat në korporatat tjera depozituese.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Bankat komerciale.

Tabela 13. Depozitat në korporatat tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Depozitat në korporatat tjera depozituese janë të ndara sipas sektorëve, nënsektorëve dhe sipas valutave.

Deri në maj 2004, depozitat janë klasifikuar në depozitat e personave fizik dhe personave juridik. Në kuadër të depozitave të personave juridik janë përfshirë depozita e të gjitha institucioneve përveç atyre bankare dhe të ekonomive familjare. Për më shumë, në kuadër të depozitave të ekonomive familjare, deri në maj 2004, janë përfshirë edhe depozitat e OJSHEF-ve. Që nga

qershori 2004 e deri në dhjetor 2007, depozitat e kompanive të sigurimit përfshijnë edhe depozitat e fondeve pensionale.

Klasifikimi i depozitave në maturitete është bërë bazuar në kriterin e maturimit origjinal (p.sh. nëse në janar 2012 kemi depozitim për një afat maturimit një vjeçar, atëherë ky afatizim do të raportohet në kuadër të zërit “Deri në një vit” deri në momentin kur të kryhet afatizimi). Që nga viti 2010, depozitat e kursimit raportohen si zë i veçantë, që më parë përfshiheshin në kuadër të depozitave të afatizuara, sipas afateve. Po ashtu, që nga janari 2010 ekziston edhe një ndarje më e detajuar në kuadër të strukturës së afateve në depozita. Në kuadër të zërit “mbi 2 vite dhe deri në 5 vite”, deri në fund të vitit 2009 përfshihen të gjitha depozitat me afat “mbi 2 vite”.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Bankat komerciale.

Tabela 14. Kreditë e e Korporatave Tjera Depozituese (KTD)

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Kreditë e korporatave tjera depozituese janë paraqitur (1) si gjendje kumulative dhe (2) si kredi të reja të dhëna gjatë muajit.

Në kuadër të kredive kumulative është përfshirë vlera e kredive aktive, respektivisht kërkesave të korporatave tjera depozituese ndaj sektorëve përkatës, korporatave publike jofinanciare, korporatave private jofinanciare dhe ekonomive familjare, të ndara sipas afateve. Në këtë kontekst, nuk është përfshirë aktiviteti ndërbankar kreditor. Deri në fund të vitit 2009, kreditë dhe lizingu ishin të paraqitura në një zë bilancor, mirëpo që nga viti 2010, këta dy zëra paraqiten si të ndarë. Përveç ndarjes në sektorët dhe nën sektorët institucional, kreditë janë ndarë edhe sipas qëllimit. Kjo ndarje është bazuar në klasifikimin NACE lidhur me sektorët ekonomik.⁵

Kreditë e reja përfshijnë kreditë e dhëna vetëm brenda një periudhe referuese dhe si të tilla janë të dhëna jokumulative (p.sh. kreditë për muajin maj 2012 paraqesin vetëm kreditë e dhëna gjatë atij muaji, duke mos përfshirë kreditë e dhëna gjatë periudhave paraprake, siç është rasti tek kreditë kumulative).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Bankat komerciale.

Tabela 15. Normat efektive të interesit të korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Normat e interesit llogariten dhe publikohen duke përdorur normën efektive vjetore. Sektorët janë ndarë korporatat jofinanciare dhe në ekonomitë familjare, konsistente me standardet ndërkombëtare.

Që nga janari 2008 ka një ndryshim metodik ku në kuadër të normave të interesit në kredi përfshihen edhe shpenzimet administrative që aplikohen nga bankat komerciale për kreditë e

⁵ Për më shumë rreth klasifikimit NACE shih http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-07-015/EN/KS-RA-07-015-EN.PDF

dhëna e që paguhen nga kredimarrësit. Po ashtu, që nga janari 2008, statistikat lidhur me mbitërheqjet paraqiten si kumulative dhe si të tilla nuk përfshihen me rastin përlogaritjes së normës së mesatares aritmetike të ponderuar. Që nga viti 2010, me rastin e llogaritjes së normës së ponderuar, nuk përfshihen kreditë me kushte favorizuese. Po ashtu, që nga kjo periudhë, është aplikuar një ndarje e re e kredive sipas qëllimit, konsistent me sistemin NACE.

Me rastin e llogaritjes dhe publikimit të normës efektive të kamatës për të gjitha korporatat tjera depozituese, përdoret mesatarja aritmetike e ponderuar dhe kriteret si devijimi standard dhe minimumi i observimeve. Formula e llogaritjes së normës efektive është me sa vijon:

$$AAR = \left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1$$

ku *AAR* është norma e kontraktuar e vjetorizuar, *AG* paraqet normën nominale të kontraktuar në mes të palëve, dhe *n* është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Atëherë, $n = 1$ nëse interesi paguhet një herë në vit (12/12), $n = 2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj (12/6), $n = 4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj (12/3), dhe $n = 12$ kur interesi paguhet çdo muaj (12/1).

Këto të dhëna janë jokumulative që përfshijnë kontratat e reja gjatë muajit përkatës. Për më shumë rreth llogaritjes së normës së interesit konsultoni [Raportin mbi Normat e Kamatës](#).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Bankat komerciale.

Tabela 16. Bilanci i suksesit i korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Bilanci i suksesit i korporatave tjera depozituese paraqet gjendjen e agreguar të të hyrave dhe shpenzimeve bankare. Struktura e të hyrave ndahet sipas kriterit të mjeteve që sjellin interes (të hyrat nga interesi) dhe të hyrave të tjera. I njëjti kriter aplikohet edhe tek klasifikimi i shpenzimeve. Të dhënat në bilancin e suksesit janë të dhëna jokumulative, respektivisht, prezantohen si kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2012 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2012, ndërsa të dhënat për maj 2012 përfshijnë të dhënat që nga janari 2012 deri në maj 2012).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Bankat komerciale.

Tabela 17. Bilanci i gjendjes së ndërmjetësve tjerë financiar

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare. Bilanci i gjendjes i ndërmjetësve tjerë financiar paraqet gjendjen e agreguar të këtij nënsektori. Që nga qershori 2004 deri në dhjetor 2011 të dhënat mbi ndërmjetësit tjerë financiar janë publikuar në baza tremujore,

ndërsa që nga janari 2012, këto statistika përpilohen në baza mujore. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të Raportit Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Institucionet mikrofinanciare.

Tabela 18. Kreditë e ndërmjetësve tjerë financiar

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare që janë të angazhuara në dhënien e kredive në Kosovë. Kreditë e korporatave tjera mikrofinanciare janë paraqitur (1) si gjendje kumulative dhe (2) si kredi të reja të dhëna gjatë muajit.

Në kuadër të kredive kumulative është përfshirë vlera e kredive aktive, respektivisht kërkesave të ndërmjetësve tjerë financiar ndaj sektorëve tjerë, korporatave publike jofinanciare, korporatave private jofinanciare dhe ekonomive familjare, të ndara sipas afateve.

Kreditë e reja përfshijnë kreditë e dhëna vetëm brenda një periudhe referuese dhe si të tilla janë të dhëna jo kumulative (p.sh. kreditë për muajin maj 2012 paraqesin vetëm kreditë e dhëna gjatë atij muaji, duke mos përfshirë kreditë e dhëna gjatë periudhave paraprake, siç është rasti tek kreditë kumulative). Përveç ndarjes në sektorët dhe nën sektorët institucional, kreditë janë ndarë edhe sipas qëllimit. Kjo ndarje është bazuar në klasifikimin NACE lidhur me sektorët ekonomik.⁶

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Institucionet mikrofinanciare.

Tabela 19. Normat efektive të interesit të ndërmjetësve tjerë financiar

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare. Ndërmjetësit tjerë financiar përfshijnë institucionet mikrofinanciare të cilat së bashku me korporatat tjera depozituese (bankat komerciale) janë institucionet e vetme në kuadër të sistemit financiar të Kosovës të licencuara për dhënien e kredive.

Normat e interesit llogariten dhe publikohen duke përdorur normën efektive vjetore. Sektorët janë ndarë korporatat jofinanciare dhe në ekonomitë familjare, konsistente me standardet ndërkombëtare. Formula e llogaritjes së normës efektive është me sa vijon:

$$Eff = \frac{\left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1}{fee}; \quad fee = 1 - disagio$$

⁶ Për më shumë rreth klasifikimit NACE shih http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-07-015/EN/KS-RA-07-015-EN.PDF

ku Eff është norma e kontraktuar e vjetorizuar, AG paraqet normën nominale të kontraktuar në mes të palëve, dhe n është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Atëherë, $n = 1$ nëse interesi paguhet një herë në vit (12/12), $n = 2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj (12/6), $n = 4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj (12/3), dhe $n = 12$ kur interesi paguhet çdo muaj (12/1). Raportimi i normave të kamatës në BQK nuk do të përfshijë asnjë taksë, tatim as ndonjë shpenzim tjetër të ndërlidhur me palët e treta, si taksat për shtetin, të cilat banka i paguan për klientin. Megjithatë, kosto (*shpenzimet administrative: fee*) e manifestuar si një zbritje (*disagio*) në rastin e një kredie duhet të konsiderohet si një pagesë e kamatës. *Disagio*, e përcaktuar si diferencë midis shumës nominale të kredisë dhe shumës së marrë nga klienti, do të konsiderohet si pagesa e kamatës në fillim të kontratës (*koha t_0*) dhe do të reflektohet në normën vjetore të dakorduar. *Disagio* është e lidhur direkt me procesimin e kredisë dhe kjo është një kosto interesi për marrëveshje specifike të kredisë ose kontratë të re. Këto të dhëna janë jokumulative që përfshijnë kontratat e reja gjatë muajit përkatës.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Institucionet mikrofinanciare.

Tabela 20. Bilanci i suksesit të ndërmjetësve tjerë financiar

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, agjencive për transferimin e parave dhe këmbimoreve. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare. Bilanci i suksesit të ndërmjetësve tjerë financiarë paraqet gjendjen e agreguar të të hyrave dhe shpenzimeve të institucioneve mikrofinanciare. Struktura e të hyrave ndahet sipas kriterit të mjeteve që sjellin interes (të hyrat nga interesi) dhe të hyrave të tjera. I njëjti kriter aplikohet edhe tek klasifikimi i shpenzimeve. Të dhënat në bilancin e suksesit të dhënat janë jokumulative, respektivisht, prezantohen në sistemin kumulativ brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2012 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2012, ndërsa të dhënat për maj 2012 përfshijnë të dhënat që nga janari 2012 deri në maj 2012).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Institucionet mikrofinanciare.

Tabela 21. Bilanci i gjendjes së ndihmësve financiar

Përshkrimi: Ndhmësit financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente që ndihmojnë në ndërmjetësimin financiar. Në Kosovë, ndihmësit financiar përbëhen nga agjencitë për transferimin e parave. Bilanci i gjendjes i ndihmësve financiar paraqet gjendjen e agreguar të këtij nënsektori. Deri në dhjetor 2011 të dhënat mbi ndërmjetësit tjerë financiar janë publikuar në baza tremujore, ndërsa që nga janari 2012, këto statistika përpilohen në baza mujore. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të Raportit Statistikor mbi Agjencitë për Transferimin e Parave.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Agjencitë për transferimin e parave.

Tabela 22. Bilanci i suksesit i ndihmësve financiar

Përshkrimi: Ndhmësit financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente që ndihmojnë në ndërmjetësimin financiar. Në Kosovë, ndihmësit financiar përbëhen nga agjencitë për transferimin e parave. Bilanci i suksesit të ndihmësve financiar paraqet gjendjen e agreguar të të

hyrave dhe shpenzimeve të këtyre institucioneve. Struktura e të hyrave ndahet sipas kriterit të mjeteve që sjellin interes si të hyrat nga transferet dhe të hyrat nga interesi. I njëjti kriter aplikohet edhe tek klasifikimi i shpenzimeve. Të dhënat në bilancin e suksesit të dhënat janë jokumulative, respektivisht, prezantohen në sistemin kumulativ brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2012 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2012, ndërsa të dhënat për maj 2012 përfshijnë të dhënat që nga janari 2012 deri në maj 2012).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Agjencitë për transferimin e parave.

Tabela 23. Bilanci i gjendjes i kompanive të sigurimit

Përshkrimi: Kompanitë e sigurimeve janë korporata financiare që janë të angazhuara në aktivitetet e sigurimit të automjeteve, sigurimit të dëmeve, sigurimit shëndetsorë, sigurimit jetësor, etj. Bilanci i gjendjes së kompanive të sigurimit paraqet pozicionin financiar të kompanive të sigurimit. Nga viti 2004 deri në mars 2016 të dhënat mbi kompanitë e sigurimit janë publikuar në baza tremujore, ndërsa që nga prilli 2016, këto statistika përpilohen në baza mujore.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Kompanitë e sigurimit.

Tabela 24. Sistemi i pagesave

Përshkrimi: Të dhënat lidhur me pagesat ndërbankare përfshinë statistika lidhur me vlerën e mbitërheqjeve në bankomate, pikave të shitjes (POS), shfrytëzimit të e-bankingut, etj. Këto statistika janë informata kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2012 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2012, ndërsa të dhënat për maj 2012 përfshijnë të dhënat që nga janari 2012 deri në maj 2012). Për dallim nga statistikat që paraqesin vlerën e transaksioneve, statistikat mbi numrin e bankomatëve, pikave shitëse elektronike (Point of Sale), llogarive bankare si dhe numri i llogarive e-banking janë të dhëna kumulative.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK.

Tabela 25. Rrjeti i korporatave tjera depozituese dhe numri i të punësuarve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Të dhënat mbi rrjetin e korporatave tjera depozituese (bankave komerciale) janë paraqitur në nivel të rajoneve të Kosovës. Në kuadër të njërive bankare përfshihen zyrat kryesore, degët, nëndegët, dhe të gjitha njësitë tjera bankare. Të dhënat mbi rrjetin bankar dhe mbi stafin e bankave komerciale janë të dhëna kumulative.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK.

Tabela 26. Aktiviteti i kompanive të sigurimeve

Përshkrimi: Kompanitë e sigurimeve janë korporata financiare që janë të angazhuara në aktivitetet e sigurimit të automjeteve, sigurimit të dëmeve, sigurimit jetësor, etj. Në kuadër të aktivitetit të kompanive të sigurimit janë paraqitur të hyrat në emër të sigurimeve vendore të automjeteve (sigurimet ndaj palës së tretë), sigurimet kufitare dhe sigurimet tjera (sigurimi i pronave, sigurimet nga zjarri, dhe sigurimet nga fatkeqësitë tjera). Konsistent me këtë ndarje janë paraqitur edhe numri i policave të shitura si dhe shpenzimet e kompanive të sigurimit.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK.

Tabela 27. Buxheti i Kosovës

Përshkrimi: Tabela mbi buxhetin e Kosovës prezanton të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Të hyrat janë ndarë në të hyra kufitare dhe vendore të cilat më pastaj janë detajuar sipas konform klasifikimeve të bëra nga Ministria e Financave. Shpenzimet buxhetore janë paraqitur bazuar në qëllimin e shpenzimit të detajuar sipas bartësve (niveleve qeveritare).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Ministria e Financave.

Tabela 28. Produkti i brendshëm bruto

Përshkrimi: Të dhënat mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) janë të dhëna nominale. Kategoria IJPSHESH ka të bëjë me organizatat jo me qëllim fitimi që i shërbejnë ekonomive familjare që në Buletin Mujor Statistikor është prezantuar si OJSHEF. Në kuadër të eksportit neto përfshihen eksporti dhe importi i mallrave si dhe eksporti dhe importi i shërbimeve. Statistikat e PBB-së janë paraqitur sipas qasjes së shpenzimeve dhe sipas sektorëve ekonomik.

Periodiciteti: Vjetor

Burimi i të dhënave: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tabela 29. Çmimet

Përshkrimi: Statistikat mbi çmimet përpilohen sipas klasifikimit të konsumit individual sipas qëllimit (COICOP) duke përdorur peshat specifike në nivel të çdo kategorie dhe nën kategorie.⁷ Statistikat mbi çmimet mblidhen nga qendrat rajonale siç janë Ferizaj, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Prizreni dhe Prishtina. Statistikat mbi çmimet janë paraqitur bazuar në ndryshimin vjetor të çmimeve. Ndryshimi vjetor është bazuar në formulën e rritjes/zvoglimit vjetor. Formula për llogaritjen e ndryshimit vjetor të çmimeve është me sa vijon:

$$\text{Ndryshimi vjetor} = \left[\left(\frac{CPI^{Y,m}}{CPI^{Y-1,m}} \right) - 1 \right] * 100$$

⁷ Për më shumë rreth klasifikimit COICOP shih <http://unstats.un.org/unsd/cr/registry/regcst.asp?Cl=5>

ku $CPI^{Y,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit aktual, ndërsa $CPI^{Y-1,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit paraprak.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tabela 30.1. Bilanci i pagesave

Përshkrimi: Statistikat e bilancit të pagesave janë të dhëna jokumulative. Statistikat e bilancit të pagesave përpilohen dhe publikohen sipas standardeve statistikore ndërkombëtare, duke paraqitur anën kreditore dhe debitore në nivel të çdo komponenti. Kategoria e mallrave përfshinë edhe shpenzimet e sigurimit dhe transportit. Në kuadër të transfereve rrjedhëse, është përfshirë edhe buxheti i UNMIK-ut i cili si institucion, për qëllime statistikore trajtohet si jorezident, ndërsa stafi i tij, trajtohet bazuar në kriterin e rezidencës (periudha një vjeçare). Ky trajtim vlen edhe për EULEX-in. Po ashtu edhe KFOR-i është pjesë e bilancit të pagesave të Kosovës. Për më shumë rreth trajtimit të UNMIK-ut, EULEX-it, KFOR-it, etj, shih: Metodikën mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave të Kosovës.

Një nga komponentët kryesorë në kuadër të statistikave të bilancit të pagesave janë dërgesat e emigrantëve (remitancat). Statistikat mbi dërgesat e emigrantëve (remitancat) janë paraqitur sipas kanaleve të dërgimit dhe shteteve. Ndarja e dërgesave të emigrantëve sipas kanaleve është bërë duke u bazuar në kanalet institucionale (bankat komerciale dhe agjencitë për transferimin e mjeteve) dhe kanalet joinstitucionale. Këto statistika janë jokumulative.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK, korporatat tjera depozituese, korporatat jofinanciare, institucionet qeveritare, etj.

Tabela 31.1 Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

Përshkrimi: Statistikat e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (PIN) janë të dhëna kumulative, të cilat përpilohen dhe publikohen sipas standardeve statistikore ndërkombëtare. PIN paraqet bilancin gjendjen e aseteve dhe detyrimeve të jashtme financiare të një vendi me vendet tjera në fund të një periudhe të caktuar. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve dhe korigjimeve që rezultojnë nga lëvizjet në kursin e këmbimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. PIN-i përbëhet nga: (i) investimet në ekuitet neto (investimet në kapital aksionar jashtë vendi minus investimet e huaja në kompanitë e vendit) dhe (ii) borxhi ndërkombëtar neto i një vendi (kreditimi tek jorezidentët minus huamarrjet nga jorezidentët). Shiquar pozicionin e investimeve ndërkombëtare sipas viteve, ekonomia e Kosovës ka qenë vazhdimisht neto kreditor ndaj vendeve të tjera të botës. Një vend neto kreditor nënkupton se asetet ndërkombëtare neto i ka më të larta se sa detyrimet ndërkombëtare.

Tabela e harmonizimit në mes të BP-se dhe IIP-se, paraqet një ndërlidhje të ngushtë ndërmjet PIN-it dhe statistikave të bilancit të pagesave. Llogaria financiare e bilancit të pagesave paraqet transaksionet që kanë të bëjnë me asetet dhe detyrimet e jashtme financiare të Kosovës, të cilat ndikojnë në gjendjen kumulative të mjeteve dhe detyrimeve financiare të jashtme të paraqitura në PIN. Transaksionet financiare mund të ndodhin për shkak të rritjes/zvogëlimit të aseteve/detyrimeve dhe fitimit/humbjes në asete/detyrime (p.sh. nga interesi nga investimet apo shpërndarja e dividendës). Statistikat e PIN-it që nga viti 2007 janë publikuar në baza vjetore ndërsa që nga viti 2012 në bazë tremujore.

Periodiciteti: Tremujore

Burimi i të dhënave: BQK, korporatat tjera depozituese, korporatat jofinanciare, instituc-ionet qeveritare, etj.

Tabela 32.3. Investimet direkte

Përshkrimi: Investimet e huaja direkte përbëhen nga investimet e jorezidentëve në Kosovë dhe investimet e rezidentëve jashtë Kosovës. Statistikat mbi investimet e huaja direkte janë paraqitur sipas sektorëve dhe shteteve. Ndarja e investimeve të huaja sipas kategorive ekonomike është bazuar në fushën e investuar dhe përfshin investimet nga procesi i privatizimit dhe investimet e reja. Këto statistika janë jokumulative. Në kuadër të investimeve përfshihen edhe kreditë ndërmjet kompanive rezidente dhe jorezidente.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Korporatat tjera depozituese, korporatat jofinanciare, etj.

Tabela 33.1 Borxhi i jashtëm

Përshkrimi: Borxhi i jashtëm i Kosovës paraqet detyrimet e rezidentëve të Kosovës ndaj jorezidentëve në një përudhë të caktuar kohore. Borxhi i jashtëm bruto tregon borxhin e përgjithshëm publik dhe privat të Kosovës, ndërsa borxhi i jashtëm neto tregon pozicionin neto të investimeve ndërkombëtare të Kosovës, që nënkupton diferencën midis investimeve të jorezidentëve në Kosovë (detyrimeve) dhe investimeve të rezidentëve Kosovarë jashtë vendit (aseteve). Në kuadër të borxhit privat përfshihet i gjithë sektori privat që në rastin e Kosovës përbënë kategorinë kryesore të borxhit të jashtëm.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Ministria e Financave.

Tabela 34.1 Pasqyra e harmonizuar e investimeve portofolio

Përshkrimi: Pasqyra e harmonizuar e investimeve portofolio paraqet investimet në ekuitet dhe në letra me vlerë të borxhit që më tutje ndahen në afatshkurtër dhe afatgjatë. Investimet portofolio më tutje janë ndarë sipas shteteve dhe paraqet gjendjen e akumuluar. Ky format i prezantimit raportohet në baza të rregullta periodike në Fondin Monetare Ndërkombëtar.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK, korporatat tjera depozituese, korporatat jofinanciare, etj.

Tabela 35 Tregtia në mallra

Përshkrimi: Statistikat mbi bilancin tregtar janë paraqitur sipas shteteve dhe komponentëve kryesore. Shtetet janë grupuar në shtetet e Bashkësisë Evropiane, CEFTA-s, vendeve të tjera evropiane dhe jo evropiane. Eksportet janë paraqitur sipas shtetit destinues, ndërsa importi i të mallrave është bërë sipas shtetit të origjinës. Në kuadër të bilancit tregtar është paraqitur edhe tabela mbi importin e mallrave e ndërthurur me komponentë kryesor (prezantimi matricor) që tregon kategorinë e mallrave të importuar sipas shtetit përkatës.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tabela 36. Kursi devizor

Përshkrimi: Kursi devizor përpilohet bazuar në mesataren mujore të valutave kundrejt valutës euro. Valutat e paraqitura janë valuta të shteteve që paraqesin partnerët kryesor tregtar të Kosovës dhe vendeve të rajonit. Norma Reale Efektive të Këmbimit (NREK) llogaritet duke përdorur Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Para se të llogaritet NREK, që më parë duhet të llogarisim Normën Nominale Efektive e Këmbimit (NNEK). Formula lidhur me llogaritjen e NNEK-ut është me sa vijon:

$$NNEK_t = 100 \sum_{i=1}^n \frac{E_{it}}{E_{i0}} w_i$$

ku i paraqet valutat individuale të vendeve, E_{it} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendeve në baza mujore (t) e definuar si numri i njësive të valutës së vendit (i) për një njësi të valutës vendore, E_{i0} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendit përkatës në periudhën bazë, dhe w_i është pesha për valutën e vendit (i).

Më pastaj llogarisim NREK-un bazuar në formulën me sa vijon:

$$NREK_t = \sum_{i=1}^n \frac{w_i P_{dt}}{P_{ft}} NNEK_t$$

ku P_{ft} paraqet indeksin për çmimet e huaja në baza mujore (t) për secilin vend veç e veç duke krahasuar me periudhën bazë, përderisa P_{dt} paraqet IÇK-në e Kosovës në baza mujore (t) krahasuar me periudhën bazë.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Agjencia e Statistikave të Kosovës, agjencitë përkatëse të vendeve të rajonit.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org